



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ENERGJISË
DHE INDUSTRIË

Nr. 7197 Prot.

Tiranë, më 05/12/2016

Drejtuar: Paleve te interesuara,

Subjekti: Dhenie mendime lidhur me Draft Vendimin e Keshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores per kategoritë, kushtet, kërkesat e kualifikimit dhe të eksperiencës profesionale për licencimin e audituesit të energjisë”.

Përshëndetje,

Ministria e Energjisë dhe Industrisë ka pasur vazhdimisht mbështetjen e palëve të interesuara lidhur me shume draft dokumente të tjerë, dhe me këtë rast dëshiron të falënderojë secilin qe ka dhënë kontribut si pale e interesuar

Se fundi drejtorja e Burimeve Energjetike të Rinovueshme dhe Efiçencës se Energjisë ka përpunuar draft – vendimin e Keshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores per kategoritë, kushtet, kërkesat e kualifikimit dhe të eksperiencës profesionale për licencimin e audituesit të energjisë” e cila me siguri do të jete dokument qe do të hape vende pune dhe mbi të gjitha do të ndihmoje në auditimin e energjisë tek konsumatorëve të mëdhenj sipas kërkesave të ligjit 124/2015 “Për Efiçencën e Energjisë”. Gjithashtu në kuadër të ligjit 116/2016 “Për Performancën e Energjisë në Ndërtesa”, të cilin Parlamenti e miratoi vetëm tre jave me pare, audituesit e licencuar të energjisë do të fillojnë procesin e certifikimit të performances se Energjisë në Ndërtesa.

Audituesit e energjisë qe do të licencohen sipas kësaj procedure, gjithashtu do ti nënshtrohen edukimit të vazhduar dhe testimit përpara se të pajisen me licence nga QKB (QKL)

Ne mënyre qe të jemi sa me transparent me palët e interesuara, të cilat, kërkojnë të ushtrojnë aktivitetin e auditit të energjisë dhe operojnë në fushën e Efiçencës se Energjisë i ftojme të japin mendimin e tyre në takimet e organizuara nga MEI në datat 13 dhe 20 Dhjetor 2016 ora 10.00am në mjediset e MEI. Linkun për draft VKM-në mund ta gjeni në faqen zyrtare

<http://www.energjia.gov.al/al/publikime/trasparence-per-publikun>

Per cdo sygjerim: info@energjia.gov.al mbetemi të hapur për të përmirësuar Draft-Dokumentin.

Ju ftojme me kenaqesi te jeni pjese e kdtij procesi.

Ju falënderojmë për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin

SEKRETAR I PERGJITHSHEM

Koli BELE

